

VENDIM
Nr.1484, datë 12.11.2008

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.23, DATË 9.1.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR TARIFAT E PËRDORIMIT TË UJIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 57 të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 1 të vendimit nr.23, datë 9.1.2008 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

“1.1 Tarifat e përdorimit të ujit, të parashikuara në pikën 4 të tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, janë 0, kur:

i) në kontratën e koncesionit, për hidrocentrale, të lidhur nga autoriteti përkatës kontraktor, është parashikuar pagimi i tarifës së koncesionit nga ana e koncesionarit;

ii) KESH sh.a. do të jetë shoqëri publike.”.

2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave dhe këshillat e baseneve të ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha